MAIN NEWS of today Thursday, February 10, 2011

| MEDIA: | Gazeta Shqiptare | TYPE: | newspaper |
|---|---|---|---|
| DATE: | Thursday, February 10, 2011 | FREQUENCY: | daily |
| PAGE: | 13 | REACH: | 36266 |
| CATEGORY | Ekonomy | Color | |
| HEADLINE: | **Albania and The EPO on IP development** | | |

The President of the European Patent Office (EPO), Benoît Battistelli, paid his first official visit to Albania since the country become a member of the European Patent Organization in May 2010, to discuss the development possibilities of the Albanian system of Intellectual Property. The EPO will start implementing this year the IPA national project "Developing the Industrial Property System in Albania" which is funded by the EU Delegation to Albania. This office is responsible for issuing European patents that are viable in all the 38 countries member of the organization, covering 600 million population.

**Shqipëria dhe Zyra Evropiane e Patentave mbi pronën intelektuale**

Presidenti i Zyrës Evropiane të Patentave (EPO), Battistelli, vizitoi për herë të parë Shqipërinë që kur vendi u bë anëtar i Organizatës Evropiane të Patentave në maj 2010, për të diskutuar mbi mënyrat e zhvillimit të mëtejshëm të sistemit shqiptar për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Zyra Evropiane e Patentave do të filojë këtë vit zbatimin e projektit kombëtar IPA " Zhvillimi i Sistemit të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri", që financohet nga delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Kjo Zyrë është përgjegjëse për lëshimin e patentave evropiane që janë të vlefshme në disa ose në të gjitha 38 vendet anëtare të Organizatës, duke mbuluar një zonë prej afro 600 milionë banorësh.



| MEDIA: | Ekonomia | TYPE: | newspaper |
| --- | --- | --- | --- |
| DATE: | Thursday, February 10, 2011 | FREQUENCY: | daily |
| PAGE: | 3 | REACH: | 936 |
| CATEGORY | politics | Color | |
| HEADLINE: | **Albania member of the European Patent Office** | | |

Prime minister Berisha welcomed yesterday the European Office of Licenses, headed from its president Benoitt Battistelli. Mr. Battistelli after thanking the prime minister for the time and interest shown, spoke on behalf of his office his gratitude for the cooperation with Albania, as the newest member of the most important of the EU. He emphasized that Albania, as the newest member of this organization will have its role in the structures of the European Office for Patents. The prime minister emphasized the importance of the office and the cooperation of the Albanian office with the European one. The prime minister emphasized that Albania was clear on the long term benefit of the opening of this office.

# Shqipëria antare e Zyrës Europiane të Patentave

Kryeministri Berisha priti dje në takim një delegacion nga Zyra Europiane e Patentave, të kryesuar nga Presidenti i saj Benoit Battistelli. Zoti Battistelli, pasi falënderoi Kryeministrin për kohën dhe interesin e dedikuar, i shprehu në emër të zyrës që ai kryeson, kënaqësinë për bashkëpunimin me Shqipërinë, si anëtarja më e re e këtij organizmi shumë të rëndësishëm të Bashkimit Europian. Numri i vendeve është 38, tha zoti Battistelli, por numri i anëtarëve si individë është me miliona. Është hera e parë, u shpreh më tej ai, që vizitoj Shqipërinë dhe u impresionova me atë çka pashë. Zoti Battistelli e konsideroi të rëndësishme hyrjen e Shqipërisë në këtë organizëm, duke shprehur besimin se duke punuar së bashku do të prezantojmë standardet europiane të pronësisë industriale dhe intelektuale edhe në Shqipëri. Zoti Battistelli tha se Shqipëria si anëtarja më e re e këtij organizmi do të ketë rolin e saj në strukturat e Zyrës Europiane të Patentave. Kryeministri Berisha e falënderoi zotin Battistelli për këtë vizitë dhe e siguroi se për qeverinë shqiptare problemi i pronësisë industriale dhe intelektuale është shumë i rëndësishëm. Në këtë drejtim, prezantimi i standardeve europiane dhe forcimi i kapaciteteve të Zyrës shqiptare përbën një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit. Kryeministri shprehu besimin se përfitimet e anëtarësimit në këtë organizëm europian janë të shumanshme. Kryeministri theksoi se qeveria do të mbështesë pa rezerva e me prioritet zhvillimin e kësaj Zyre dhe realizimin e objektivave të saj, si dhe bashkëpunimin e Zyrës shqiptare me Zyrën Europiane të Patentave, në drejtim të formimit të ekspertëve publikë e privatë, të zhvillimit të kapaciteteve teknike dhe prezantimit të standardeve europiane në modernizimin e funksionimit të saj. Qeveria shqiptare, tha Kryeministri, është e ndërgjegjshme për përfitimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë organizëm dhe nga mbështetja e zhvillimi i pronësisë industriale. Patentat dhe markat e regjistruara dhe të mbrojtura përbëjnë një nxitje dhe garanci për sipërmarrësit vendas dhe në tërheqjen e investitorëve dhe sipërmarrësve të huaj.



| | | | |
|---|---|---|---|
| MEDIA: | Ballkan | TYPE: | newspaper |
| DATE: | Thursday, February 10, 2011 | FREQUENCY: | daily |
| PAGE: | 6 | REACH: | 936 |
| CATEGORY | Ekonomy | Color | |
| HEADLINE: | Berisha welcomes the delegation from the Licenses Office of europe | | |

Prime minister Berisha welcomed yesterday the European Office of Licenses, headed from its president Benoitt Battistelli. Mr. Battistelli after thanking the prime minister for the time and interest shown, spoke on behalf of his office his gratitude for the cooperation with Albania, as the newest member of the most important of the EU. He emphasized that Albania, as the newest member of this organization will have its role in the structures of the European Office for Patents. The prime minister emphasized the importance of the office and the cooperation of the Albanian office with the European one. The prime minister emphasized that Albania was clear on the long term benefit of the opening of this office.

# Berisha pret një delegacion nga Zyra Evropiane e Patentave

Kryeministri Berisha priti dje në takim një delegacion nga Zyra Evropiane e Patentave, të kryesuar nga presidenti i saj, Benoit Battistelli. Battistelli, i shprehu Berishës, në emër të zyrës që ai kryeson, kënaqësinë për bashkëpunimin me Shqipërinë, si anëtarja më e re e këtij organizmi shumë të rëndësishëm të Bashkimit Evropian. "Numri i vendeve është 38, – tha Battistelli, – por numri i anëtarëve si individë është me miliona. Është hera e parë, u shpreh më tej ai, që vizitoj Shqipërinë dhe u impresionova me atë çka pashë". Ai e konsideroi të rëndësishme hyrjen e Shqipërisë në këtë organizëm, duke shprehur besimin se, duke punuar së bashku, do të prezantojmë standardet evropiane të pronësisë industriale dhe intelektuale edhe në Shqipëri. Battistelli tha më tej se Shqipëria, si anëtarja më e re e këtij organizmi, do të ketë rolin e saj në strukturat e Zyrës Evropiane të Patentave.



| | | | |
|---|---|---|---|
| MEDIA: | Gazeta 55 | TYPE: | newspaper |
| DATE: | Thursday, February 10, 2011 | FREQUENCY: | daily |
| PAGE: | 11 | REACH: | 936 |
| CATEGORY | Politics | Color | B/W |
| HEADLINE: | Berisha – Battistelli: registered Licenses, incentive for foreign investors | | |

Prime minister Berisha welcomed yesterday the European Office of Licenses, headed from its president Benoitt Battistelli. Mr. Battistelli after thanking the prime minister for the time and interest shown, spoke on behalf of his office his gratitude for the cooperation with Albania, as the newest member of the most important of the EU. There are only 38 countries, but the members amount to millions. He emphasized that Albania, as the newest member of this organization will have its role in the structures of the European Office for Patents. The prime minister emphasized the importance of the office and the cooperation of the Albanian office with the European one. The prime minister emphasized that Albania was clear on the long term benefit of the opening of this office.

# Berisha–Battistelli: Patentat e regjistruara, nxitje për tërheqjen e investitorëve

Kryeministri Berisha priti dje në takim një delegacion nga Zyra Europiane e Patentave, të kryesuar nga Presidenti i saj Benoit Battistelli. Zoti Battistelli, pasi falënderoi Kryeministrin për kohën dhe interesin e dedikuar, i shprehu në emër të zyrës që ai kryeson, kënaqësinë për bashkëpunimin me Shqipërinë, si anëtarja më e re e këtij organizmi shumë të rëndësishëm të Bashkimit Europian. Numri i vendeve është 38, tha zoti Battistelli, por numri i anëtarëve si individë është me miliona. Është hera e parë, u shpreh më tej ai, që vizitoj Shqipërinë dhe u impresionova me atë çka pashë. Zoti Battistelli e konsideroi të rëndësishme hyrjen e Shqipërisë në këtë organizëm, duke shprehur besimin se duke punuar së bashku do të prezantojmë standardet evropiane të pronësisë industriale dhe intelektuale edhe në Shqipëri. Zoti Battistelli tha se Shqipëria si anëtarja më e re e këtij organizmi do të ketë rolin e saj në strukturat e Zyrës Europiane të Patentave. Kryeministri Berisha e falënderoi zotin Battistelli për këtë vizitë dhe e siguroi se për qeverinë shqiptare problemi i pronësisë industriale dhe intelektuale është shumë i rëndësishëm. Në këtë drejtim, prezantimi i standardeve europiane dhe forcimi i kapaciteteve të Zyrës shqiptare përbën një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit. Kryeministri shprehu besimin se përfitimet e anëtarësimit në këtë organizëm europian janë të shumanshme. Kryeministri theksoi se qeveria do të mbështesë pa rezerva e me prioritet zhvillimin e kësaj Zyre dhe realizimin e objektivave të saj, si dhe bashkëpunimin e Zyrës shqiptare me Zyrën Evropiane të Patentave, në drejtim të formimit të ekspertëve publikë e privatë, të zhvillimit të kapaciteteve teknike dhe prezantimit të standardeve evropiane në modernizimin e funksionimit të saj. Qeveria shqiptare, tha Kryeministri, është e ndërgjegjshme për përfitimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë organizëm dhe nga mbështetja e zhvillimi i pronësisë industriale. Patentat dhe markat e regjistruara dhe të mbrojtura përbëjnë një nxitje dhe garanci për sipërmarrësit vendas dhe në tërheqjen e investitorëve dhe sipërmarrësve të huaj.



| MEDIA: | Rilindja Demokratike | TYPE: | newspaper |
|---|---|---|---|
| DATE: | Thursday, February 10, 2011 | FREQUENCY: | daily |
| PAGE: | 2 | REACH: | 936 |
| CATEGORY: | Politics | | |
| HEADLINE: | Battistelli: European Standards for industrial property | | |

Prime minister Berisha welcomed yesterday the European Office of Licenses, headed from its president Benoitt Battistelli. Mr. Battistelli after thanking the prime minister for the time and interest shown, spoke on behalf of his office his gratitude for the cooperation with Albania, as the newest member of the most important of the EU. He emphasized that Albania, as the newest member of this organization will have its role in the structures of the European Office for Patents. The prime minister emphasized the importance of the office and the cooperation of the Albanian office with the European one. The prime minister emphasized that Albania was clear on the long term benefit of the opening of this office.

Patentat dhe markat e regjistruara, nxitje dhe garanci për sipërmarrësit dhe tërheqjen e investitorëve

# Battistelli: Standarde evropiane për pronësisë industriale

Kryeministri Berisha priti dje në takim një delegacion nga Zyra Evropiane e Patentave, të kryesuar nga Presidenti i saj, Benoit Battistelli i cili pasi falënderoi Kryeministrin për kohën dhe interesin e dedikuar, i shprehu në emër të zyrës që ai kryeson kënaqësinë për bashkëpunimin me Shqipërinë, si anëtarja më e re e këtij organizmi shumë të rëndësishëm të Bashkimit Evropian. Numri i vendeve është 38, tha zoti Battistelli, por numri i anëtarëve si individë është me miliona. Është hera e parë, u shpreh më tej ai, që vizitoj Shqipërinë dhe u impresionova me atë çka pashë. Ndërkohë Battistelli e konsideroi të rëndësishme hyrjen e Shqipërisë në këtë organizëm, duke shprehur besimin se duke punuar së bashku do të prezantojmë standardet evropiane të pronësisë industriale dhe intelektuale edhe në Shqipëri. Zoti Battistelli tha se, Shqipëria si anëtarja më e re e këtij organizmi do të ketë rolin e saj në strukturat e Zyrës Evropiane të Patentave. Kryeministri Berisha e falënderoi Battistelli për këtë vizitë dhe e siguroi se për qeverinë shqiptare problemi i pronësisë industriale dhe intelektuale është shumë i rëndësishëm. Në këtë drejtim, prezantimi i standardeve evropiane dhe forcimi i kapaciteteve të zyrës shqiptare përbën një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit. Gjithashtu, Kryeministri shprehu besimin se përfitimet e anëtarësimit në këtë organizëm evropian janë të shumanshme. Kryeministri theksoi se qeveria do të mbështesë pa rezerva e me prioritet zhvillimin e kësaj zyre dhe realizimin e objektivave të saj, si dhe bashkëpunimin e zyrës shqiptare me Zyrën Evropiane të Patentave, në drejtim të formimit të ekspertëve publikë e privatë, të zhvillimit të kapaciteteve teknike dhe prezantimit të standardeve evropiane në modernizimin e funksionimit të saj. Qeveria shqiptare, tha Kryeministri, është e ndërgjegjshme për përfitimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë organizëm dhe nga mbështetja e zhvillimi i pronësisë industriale. Patentat dhe markat e regjistruara dhe të mbrojtura përbëjnë një nxitje dhe garanci për sipërmarrësit vendës dhe në tërheqjen e investitorëve dhe sipërmarrësve të huaj.



| MEDIA: | Koha Jone | TYPE: | newspaper |
|---|---|---|---|
| DATE: | Thursday, February 10, 2011 | FREQUENCY: | daily |
| PAGE: | 7 | REACH: | 28524 |
| CATEGORY: | Economy | | |
| HEADLINE: | Registered licenses and brands protected and a guarantee for investors | | |

The government will support fully and with high priority of developments of the European Office of patents in our country. Prime minister Berisha welcomed yesterday the European Office of Licenses, headed from its president Benoitt Battistelli. Mr. batistellu after thanking the prime minister for the time and interest shown, spoke on behalf of his office his gratitude for the cooperation with Albania, as the newest member of the most important of the EU. He emphasized that Albania, as the newest member of this organization will have its role in the structures of the European Office for Patents. The prime minister emphasized the importance of the office and the cooperation of the Albanian office with the European one. The prime minister emphasized that Albania was clear on the long term benefit of the opening of this office.

Kryeministri takon Presidentin e Zyrës Evropiane të Patentave, Battistelli

# "Patentat dhe markat e regjistruara të mbrojtura, garanci për investitorët"

Qeveria do të mbështesë pa rezerva dhe prioritet zhvillimin e Zyrës Evropiane të Patentave në vendin tonë. Kryeministri Sali Berisha, zhvilloi dje një takim me delegacionin e kësaj zyre në vendin tonë, kryesuar nga Presidenti Benoit Battistelli. Gjatë takimit, kreu i qeverisë tha se për qeverinë shqiptare problemi i pronësisë industriale dhe intelektuale është shumë i rëndësishëm. Në këtë drejtim, prezantimi i standardeve evropiane dhe forcimi i kapaciteteve të zyrës shqiptare përbën një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit. Kryeministri shprehu besimin se përfitimet e anëtarësimit në këtë organizëm evropian janë të shumanshme dhe theksoi se qeveria do të mbështesë pa rezerva e me prioritet zhvillimin e kësaj zyre dhe realizimin e objektivave të saj, si dhe bashkëpunimin e zyrës shqiptare me zyrën evropiane të patentave, në drejtim të formimit të ekspertëve publikë e privatë, të zhvillimit të kapaciteteve teknike dhe prezantimit të standardeve evropiane në modernizimin e funksionimit të saj. "Qeveria shqiptare, është e ndërgjegjshme për përfitimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë organizëm dhe nga mbështetja e zhvillimi i pronësisë industriale. Patentat dhe markat e regjistruara dhe të mbrojtura përbëjnë një nxitje dhe garanci për sipërmarrësit vendas dhe në tërheqjen e investitorëve dhe sipërmarrësve të huaj", u shpreh Berisha. Nga ana e tij, Battistelli i shprehu në emër të zyrës që ai kryeson, kënaqësinë për bashkëpunimin me Shqipërinë, si anëtarja më e re e këtij organizmi shumë të rëndësishëm të Bashkimit Evropian. "Numri i vendeve është 38, por numri i anëtarëve si individë është me miliona. Është hera e parë që vizitoj Shqipërinë dhe u impresionova me atë çka pashë", u shpreh ai.

